



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

**V E N D I M Nr.2700,**

**datë 22.12.2016**

**Për**

**“Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Sara Reçi, në mbledhjen e datës 22.12.2016, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

*“Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT ne tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”*

Dokumentacioni i Grupit të Punës përbëhet nga:

- Projekt vendimi
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit
- Dokumenti: “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”

## BAZA LIGJORE:

1. Nenet 31 e në vijim i Kreut VI të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918*);
2. Vendimi Nr. 2699, datë 01.12.2016, “*Miratimin për këshillim publik të Dokumentit: Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare– Këshillim Publik*”.
3. Rregullore Nr.9 “Për Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, e ndryshuar;

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

## V Ë R E N:

1. AKEP nëpërmjet Vendimit Nr. 2699, datë 01.12.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare– Këshillim Publik*”. Periudha e këshillimit publik e dokumentit të Analizës së Tregut është 7.12.2016-7.02.2017.
2. AKEP në dokumentin e analizës së tregut të cituar në pikën 1 më sipër, ka propozuar që katër sipërmarrësit e rrjeteve celulare Vodafone Albania, Telekom Albania, Albtelecom dhe Plus Communication, të kenë status me Fuqi te Ndjeshme në treg (FNT) në tregjet përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare si dhe detyrime/masa rregulluese për FNT si mos-diskriminim, transparencë, dhënie aksesit si edhe detyrimin për kontroll dhe rregullim të tarifave të shërbimeve të ofruara në tregjet përkatës në të cilat propozohen të kenë status me FNT. Në lidhje me masën rregulluese të kontrollit të tarifave të sipërmarrësve të propozuar për status me FNT, në dokumentin e analizës së tregut të nxjerre në këshillim publik AKEP ka sqaruar se do të zhvillojë një proces të vecantë këshillimi publik, në përputhje me përcaktimet e nenit 57 e në vijim të Ligjit 9918, për të përcaktuar metodën e kontrollit të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare të këtyre sipërmarrësve dhe specifikime të tjera të rregullimit të këtyre tarifave.
3. Dokumentacioni i paraqitur nga Grupi i Punës, përbëhet nga:
  - a) Projekt-vendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485;
  - b) Dokumenti “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik*”, i cili në përputhje me nenin 57 të Ligjit 9918, përmban metodat e rregullimit të tarifave me shumicë të sipërmarrësve të propozuar me status me FNT në dokumentin “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare– Këshillim Publik*”, miratuar nga AKEP nëpërmjet Vendimit nr. 2699, datë 01.12.2016;

c) Relacioni shpjegues për Projektvendimin e KD dhe dokumentin e rregullimit të tarifave;

4. Dokumenti: *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”*, është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm dhe masat rregulluese që do të merren në varësi të gjetjeve për FNT sipas dokumentit përkatës të analizës së tregut dhe këtij dokumenti pas procesit të këshillimit publik, kanë një ndikim të rëndësishëm në tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Referuar bazës ligjore sa mësipër,

### **V E N D O S:**

1. Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”*, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Proçedura e këshillimit publik perfundon me date 7.02.2017.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti *“Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”*, të publikohen në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Piro XHIXHO**

### **ANËTARË:**

1. Alban KARAPICI
2. Anila DENAJ
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI



**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me  
FNT në tregjet me shumicë të terminimit te  
thirrjeve në rrjetet celulare**

**Dokument për Këshillim Publik**

**Miratuar me VKD nr.2700, datë 22.12.2016**

## Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje.....	4
2. Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare ne Shqiperi .....	6
3. Tarifat benchmark të terminimit në rrjetet celulare .....	11
3.1. Rekomandimi i KE 2009/396/EC dhe propozimi i KE 2016 për rishikimin e kuadrit rregullator .....	11
3.2. Niveli mesatar i tarifave të terminimit në vendet e BE dhe BEREC .....	13
3.2.1. Tarifat mesatare të terminimit celular sipas BEREC .....	13
3.2.2. Tarifa mesatare e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër .....	16
3.2.3. Asimetria/Simetria e MTR.....	19
3.2.4. Përmbledhje e tarifave mesatare (benchmark) .....	20
4. Rregullimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare në Shqipëri ....	22
4.1 Alternativat për rishikimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare .....	22
4.2 Asimetria/Simetria dhe afati i aplikimit.....	25
4.2.1. Tarifa terminimi Asimetrike v Simetrike.....	25
4.2.2. Afati i fillimit të aplikimit të tarifës së re MTR .....	31
4.3. Efektet e Pritshme .....	32
Aneks 1: Pyetjet e keshillimit publik .....	33
Aneks 2: Lista e Shkurtimeve të Shteteve .....	34

## Lista e Tabelave dhe Figurave

### INDEKSI I TABELAVE DHE FIGURAVE

FIGURA 2.1: TARIFAT E TERMINIMIT NË VENDET E BE DHE RAJONIT DHE SHQIPËRI (2008-2016).....	9
FIGURA 3.1 TARIFAT MTR SIPAS VENDEVE TE BEREK (KORRIK 2016) .....	14
FIGURE 3.2. ECURIA E TARIFES MESARARES TE THJESHTE A(S) DHE TE PONDERUAR A(W) NË NIVEL EUROPIAN.....	15
TABELA 3.1: TARIFAT E TERMINIMIT CELULARE DHE APLIKIMI I LRIC I PASTËR BEREK 2016-2017 .....	17
TABELA 3.2: VENDET ME TARIFA TERMINIMI ASIMETRIKE.....	19
TABELA 3.3: VLERAT MESATARE TË TARIFAVE TË TERMINIMIT CELULAR (BENCHMARK) .....	20
TABELA 4.1: ASIMETRIA E TARIFAVE TË TERMINIMIT TË ALBTELECOM DHE PLUS .....	25
FIGURA 4.1: ECURIA E TRAFIKUT NETO MIDIS OPERATORËVE CELULARE 2014-16 .....	29
TABELA 4.2: VLERAT MAKSIMALE TË TARIFAVE TË TERMINIMIT CELULAR NË SHQIPËRI 2017-.....	31

# 1. Hyrje

---

AKEP nëpërmjet Vendimit Nr. 2699, datë 01.12.2016, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare– Këshillim Publik”. Periudha e këshillimit publik të dokumentit të analizës së tregut është 7-12.2016 -7.02.2017. Në lidhje me FNT në treg, AKEP në dokumentin e nxjerrë në këshillim publik ka propozuar që të katër sipërmarrësit e rrjeteve celulare të vijnë në përcaktimin me statusin e FNT për terminimin e thirrjeve në secilin prej rrjeteve të tyre:

- *Sipërmarrësi Telekom Albania sh.a përmbush kriteret për FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Telekom Albania.*
- *Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a përmbush kriteret për FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Vodafone Albania.*
- *Sipërmarrësi Altelecom sh.a përmbush kriteret për FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Altelecom.*
- *Sipërmarrësi Plus Communication sh.a përmbush kriteret për FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Plus Communication.*

Në lidhje me masat rregulluese AKEP ka propozuar që operatorët celulare të vijnë në zbatimin e masave rregulluese të përcaktuara nga analiza e mëparshme e tregut celular, transparenca, mos-diskriminimi, përfshirë detyrimin e mos-diskriminimit në tarifën e thirrjeve on-net/off-net, detyrimi për akses dhe interkoneksion, si dhe detyrimin për kontrollin dhe rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve të katër operatoreve celulare. Në lidhje me masën rregulluese të kontrollit të tarifave të terminimit, në dokumentin e analizës së tregut të nxjerrë në këshillim publik AKEP ka sqaruar se do të zhvillojë një proces të veçantë këshillimi publik, në përputhje me përcaktimet e nenit 57 e në vijim të Ligjit 9918, për të përcaktuar metodën e kontrollit të tarifave të sipërmarrësve me FNT në këto tregje përkatës.

Në përputhje me sqarimin e cituar, AKEP nxjerr këtë dokument në këshillim publik për të përcaktuar metodën e rregullimit të tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare dhe modalitetet e tjera të rregullimit të

këtyre tarifave. Procesi i këshillimit publik të këtij dokumenti përfundon më datë 7 Shkurt 2017 dhe do kryhet paralelisht me procesin e këshillimit publik të dokumentit “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare – Këshillim Publik*”. Pyetjet e këshillimit publik për këtë dokument janë dhënë në Aneks 1.

Versioni final i këtij dokumenti do të miratohet pas miratimit të versionit final të dokumentit të Analizës së Tregut, për të reflektuar ndryshimet e mundshme në përfundimet e AKEP për FNT dhe masat rregulluese të tregjeve të analizuara.



## 2. Tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare ne Shqiperi

---

Në bazë të analizës së tregut të nxjerrë në këshillim publik, “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare– Këshillim Publik*”, AKEP vleresoi se katër operatorët celulare përmbushin kriteret për fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetet e tyre celulare:

- Sipërmarresi Telekom Albania sh.a përmbush kriteret për FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Telekom Albania.
- Sipërmarresi Vodafone Albania sh.a përmbush kriteret për FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Vodafone Albania.
- Sipërmarresi Albtelecom sh.a përmbush kriteret për FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Albtelecom.
- Sipërmarresi Plus Communication sh.a përmbush kriteret për FNT në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular Plus Communication.

Veç të tjerash AKEP vleresoi dhe propozoi ,që për të katër operatorët të vijojnë të zbatojnë detyrimet e vendosura nga AKEP në dokumentin e analizës së tregut të kryer në vitin 2014. Në lidhje me tarifatat e shërbimeve të propozuar të jenë nën-rregullim sipas dokumentit të nxjerrë në këshillim publik, AKEP në këtë seksion paraqet ecurinë e tyre nga analiza e fundit si dhe duke u ndalur në disa në disa momente në lidhje me akimet në gjykatë nga operatorët të vendimeve të AKEP. Ky seksion është bazuar në informacionin e dokumentit të analizës së tregut të nxjerrë në këshillim publik.

Niveli i tarifave të terminimit në rrjetet celulare ka qënë objekt rregullimi nga AKEP (më parë ERT) që nga viti 2006. Rregullimi i këtyre tarifave nga AKEP deri në vitin 2010 është kryer duke përdorur nivelin mesatar të tarifave të terminimit në vendet e BE, dhe duke filluar nga viti 2010, ky rregullim është kryer bazuar në reduktimin e përshkallëzuar për orientimin në kosto drejt vlerës së nxjerrë nga modeli BU-LRAIC i ndërtuar në vitin 2010 nga AKEP me konsulencë ndërkombëtare.

AKEP me Vendimin nr.1505, datë 10.02.2011, miratoi dokumentin për orientimin e tarifave të terminimit në kostot BULRAIC, duke përcaktuar një grafik për reduktimin e përshkallëzuar (glide path) të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet e katër operatorëve celularë (tarifat për Plus ishin rekomanduese, pasi Plus nuk kishte status me FNT në kohën e vendim-marrjes). Vendimet 1506-1508, përcaktuan tarifat e terminimit të thirrjeve në mënyrë individuale për Telekom, Vodafone Albania dhe Altelecom.

Në dokumentin e Analizes së tregut celular, miratuar më 4.07.2012, dhe me vendimet përkatëse të FNT, AKEP ka miratuar nivelin e tarifave të terminimit të katër operatorëve celularë deri në vitin 2015 apo deri në një vendim-marrje tjetër. Tarifat e përcaktuara me vendimet 2118-2122, datë 4.07.2012 ishin të njëjta me Vendimet 1505-1508, duke konfirmuar reduktimin e përshkallëzuar të vendosur në Shkurt 2011, me disa ndryshime për operatorin Plus Communication.

Sipas vendimeve të mësipërme tarifat e terminimit të Telekom, Vodafone dhe Altelecom janë reduktuar dhe më 1.09.2013 kanë arritur nivelin e kostos 4.57 lek/minutë, ndërsa për Plus me vendimet e datës 4.07.2012 u vendos që tarifa e terminimit të arrijë nivelin 4.57 lek/minutë më 1.09.2015.

AKEP me Vendimet Nr. 2431-2435, datë 13.03.2014, vendosi që tarifat e terminimit të katër operatorëve të reduktoheshin gradualisht duke filluar nga 1.04.2014 për të arritur në nivelin 1.48 lek/minutë në 1.01.2016, e cila është sa vlera mesatare e tarifave të terminimit në vendet Evropiane që kishin aplikuar LRIC të pastër në 2013.

Bazuar në gjetjet e analizës së tregut AKEP me Vendimet nr.2522-2526, datë 06.11.2014, përcaktoi që tarifa 1.48 lek/minutë të fillonte të aplikohet që prej datës 1.12.2014 për Vodafone, Telekom Albania dhe Altelecom, ndërsa tarifa e terminimit në rrjetin Plus të qëndronte në vlerën 6.52 lek/minuteë deri në një vendim tjetër të AKEP. Bazuar në procesin e shqyrtimit të ankimeve administrative të katër operatoreve celularë për vendimet e datës 6.11.2014, AKEP me Vendimin Nr.2542, datë 13.03.2015, ndryshoi tarifën e terminimit në rrjetin Plus (të përcaktuar me Vendimet e datës 6.11.2014), duke përcaktuar një glidepath (reduktim të përshkallëzuar) në mënyrë që tarifa e terminimit në rrjetin Plus të arrinte nivelin 1.48 lek/minutë më datë 1.01.2016.

Reduktimi u përcaktua të kryhej me dy faza të ndërmjetme, që fillonin më 1.04.2015 dhe 1.07.2015.

AKEP në vijim të Vendimeve për monitorim të situatës në treg, bazuar në vlerësimin e rrethanave konkrete në treg, me VKD 2664, datë 14.01.2016, njoftoi operatorët për një pezullim 90 ditor në lidhje me fillimin e aplikimit të simetrisë me datë 1.01.2016.

AKEP me Vendim nr.2676, datë 14.04.2016, miratoi mbylljen e procesit të filluar me VKD 2664 dhe miratimin e rezultateve, duke vendosur datën 1 Prill 2016 si datë për vendosjen e simetrisë së MTR për të gjithë operatorët.

### **Proceset gjyqesore**

Sipërmarresi Plus Communication sh.a ankimoi në rrugë gjyqesore Vendimin Nr. 2542, datë 13.03.2015 duke kërkuar shfuqizimin e ndryshimeve të kryera nëpërmjet këtij vendimi, për tarifën e terminimit të thirrjeve në rrjetin Plus dhe afatin e fillimit të aplikimit të detyrimit të mos-diskriminimit në tarifatat e thirrjeve on-net dhe off-net.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr.1567, datë 1.04.2016 ka pranuar kërkesë padinë e Plus Communication. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me Vendimin Nr. 2459, datë 9.09.2016, ka lënë në fuqi Vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

AKEP ka depozituar në Gjykatën e Lartë rekurs në lidhje me Vendimin Nr.2459 datë 9.09.2016 të Gjykatës Administrative e Apelit Tiranë dhe është në pritje të sqarimeve nga Gjykata e Lartë.

Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelecom ankimuan Vendimin 2664/2016 dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr.80–2016-4342 datë 26.09.2016, pranoi kërkesë padinë e tre operatorëve. AKEP ka apeluar këtë vendim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe është në pritje të vendimit të kësaj gjykate.

Plus Communication ankimoi në rrugë gjyqesore Vendimin 2676/2016 dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin 80-2016-5079, datë 31.10.2016, pranoi


kërkesë padinë e Plus. AKEP ka apeluar këtë vendim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe është në pritje të vendimit të kësaj gjykate.

Siç mund të vihet re proceset gjyqësore kanë krijuar dhe një konfuzion në lidhje me tarifat që duhet të aplikohen për terminimin e thirrjeve në rrjetin Plus, nga data 1.04.2015 e në vijim. AKEP nuk ka të drejtë të kryejë interpretim të Vendimeve të gjyqësorit dhe ka orientuar palët në gjetjen e zgjidhjeve sipas përcaktimeve të ligjeve përkatëse.

## Niveli i tarifave MTR

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e tarifave të terminimit në rrjetet celulare të katër operatorëve për periudhën Mars 2008 deri në vitin 2016, sipas vendimeve të AKEP deri me 14.04.2016, si dhe krahasimin e këtyre tarifave në Shqipëri me tarifat mestare në vendet e BE dhe BEREC për periudhën 2008-2016.

FIGURA 2.1: TARIFAT E TERMINIMIT NË VENDET E BE DHE RAJONIT DHE SHQIPËRI (2008-2016)



Burimi: AKEP, BEREC, Kursi I kembimit i perdorur: 1 Euro=140 lek

Siç mund të vihet re, tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare të dy operatorëve më të mëdhenj në Shqipëri kanë qënë afër nivelit mesatar të vendeve të BE në vitet 2008 deri sa barazohen në vitin 2014, duke pasur një diference më të madhe në 2013 me vendet e BE dhe BEREC. Diferenca më e lartë me vendet e BEREC dhe BE në 2013 ka ardhur për shkak të reduktimeve të mëdha në vendet e BE dhe rajonit, në 2013, për orientimin në kostot LRIC të pastër. Reduktimet e AKEP të përcaktuara me Vendimet e datës 13.03.2014 e në vijim, për orientimin në kostot LRIC të pastër, duke përdorur të dhëna benchmark, kanë çuar nivelin e tarifës së terminimit për tre operatorët me të mëdhenj në nivelin 1.48 lek/minutë më datë 1.12.2014, sa tarifa mestare e vendeve të BEREC që kishin aplikuar modelin LRIC të pastër deri në vitin 2013.

# 3. Tarifat benchmark të terminimit në rrjetet celulare

---

Ky kapitull përmban informacion mbi dokumentat e KE dhe BEREC që kanë lidhje me tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare. Në seksionin e parë përshkruhen elementet kryesore të rekomandimeve të KE për tarifat e terminimit, ndërsa seksionet e tjera përmbajnë informacion në lidhje me tarifat e terminimit në vendet e BE dhe BEREC dhe krahasime të këtyre tarifave me tarifat e terminimit në Shqipëri.

## 3.1. Rekomandimi i KE 2009/396/EC dhe propozimi i KE 2016 për rishikimin e kuadrit rregullator

Komisioni Europian, BEREC në dokumenta të ndryshme ndër vite në lidhje me rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare, ka rekomanduar përdorimin e modeleve LRIC (BU, TD apo kombinim të tyre). Komisioni Europian në rekomandimin më të fundit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit, *Rekomandimi i KE i datës 7 Maj 2009 mbi trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe celulare në BE (2009/396/EC)*, ka rekomanduar autoriteteve rregullatore, midis të tjerave:

- Përcaktimin e tarifave të terminimit bazuar në kostot e ofrimit nga një operator eficient. Kjo nënkupton gjithashtu që tarifat duhet të jenë simetrike;
- Vlerësimi i kostove efiente të bazohet në kostot korrente dhe përdorimin kostove afatgjate inkrementale me metoden BU, si metodologjia e duhur e kostove;
- Regullatorët mund të përdorin krahasimin e rezultateve të modelit BU me model TD, i cili përdor të dhëna të audituara për të përmirësuar konsistencën e rezultateve dhe mund të bëjnë rregullimet e nevojshme;
- Si inkrement të përdoret shërbimi me shumicë i terminimit që i shitet operatorëve të tjerë dhe jo gjithë shërbimet si në rastin LRIC+;
- Asimetri mund të përdoret në raste kur mund të demonstron se hyrësit e rinj kanë dizavantazh në raport me operatorët e tjerë.

- Vendet që nuk kanë mundësi për aplikim modeli kostosh LRIC të pastër mund të përdorin metodën benchmark duke i'u referuar vlerave në vendet që kanë aplikuar modelin LRIC të pastër.

Zgjedhjet e dhëna nga KE në këtë rekomandim kanë ndikim në rezultatet e modeleve BULRIC të aplikuar më parë, dhe modeli i llogaritjes së kostove me zgjedhjet e përfshira në këtë rekomandim tashme njihet si LRIC i pastër (pure LRIC).

Ky rekomandim është zbatuar gjerësisht tashmë në vendet e BE dhe njëkohësisht ka filluar implementimi edhe në disa vende të rajonit. Seksioni 3.2.2 trajton aplikimin LRIC të pastër në Europë.

### **Propozimi i KE për rishikimin e kuadrit rregullator të komunikimeve elektronike**

KE nëpërmjet dokumentit të datës 14.09.2016, COM(2016) 590 final 2016/0288 (COD) “*Proposal for a DIRECTIVE OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL establishing the European Electronic Communications Code*”,<sup>1</sup> ka propozuar për rishikimin e direktivave të komunikimeve elektronike nëpërmjet hartimit të Kodit Europian të Komunikimeve Elektronike. Në lidhje me terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare, KE ka propozuar ndër të tjera që:

- Në rastet kur autoriteti rregullator kombëtar për operatorët me FNT për terminimin e thirrjeve vendos masën e kontrollit të tarifës dhe orientimit në kosto, rregullatori duhet të percaktojë tarifa maksimale simetrike për terminimin bazuar në kostot e një operator eficient.
- KE do të percaktojë një cmim tavan për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare, i cili nuk do të jetë më i madh se 1.23 eurocent/minutë
- Metodologjia e kostove duhet të bazohet në kostot korrente dhe në modelin Bottom-Up duke përdorur kostot LRIC të lidhura me trafikun për ofrimin e shërbimit të terminimit palëve të tjera.

---

<sup>1</sup> Propozimet e KE për rishikimin e kuadrit rregullator do të jenë objekt i këshillimit me palët e interesuara dhe parashikohet që të miratohen nga Parlamenti dhe Këshilli Europian fundi i vitit 2017.

- KE, në bashkëpunim me BEREC, do të përcaktojë specifikeme për modelin e kostove dhe metodologjia e kostove dhe çmimi tavan për terminimin do të rishikohen cdo 5 vjet nga Komisioni.

KE në lidhje me çmimin tavan të propozuar shpjegon se modelet LRIC të pastër kanë prodhuar vlera të kostove që variojnë nga 0.4045 në 1.226 eurocent për minutë.

### **3.2. Niveli mesatar i tarifave të terminimit në vendet e BE dhe BEREC**

Për sa i përket nivelit të tarifave mesatare të aplikuara në vendet e BE dhe BEREC, AKEP ka grumbulluar informacion duke i'u referuar burimeve të mëposhtëme:

- Të dhënat e publikuara nga BEREC për tarifën e terminimit në rrjetet celulare.
- Të dhëna të publikuara nga BEREC dhe Cullen International në lidhje me metodën e rregullimit të MTR-ve.

AKEP në dokumentat e mëparshme për tarifën benchmark të terminimit në rrjetet celulare ka përdorur të dhëna të publikuara nga KE dhe nga BEREC. Të dhënat më të fundit të publikuara nga KE në lidhje me tarifën e terminimit në vendet e BE, përmbajnë tarifën e aplikuara në 28 vendet anëtare të BE në vitin 2014, dhe KE nuk ka publikuar më të dhëna për këtë tregues në faqen eeb për axhendën digitale. Të dhëna më të përditesuara dhe detajuara për tarifën e terminimit në vendet e BE-së tashmë mund të gjenden në publikimet e BEREC, dhe AKEP në këtë dokument i referohet kryesisht këtij burimi të dhënash në lidhje me tarifën e terminimit të aplikuara në vendet e BE dhe BEREC dhe metodën e përdorur për rregullimin e tyre.

#### **3.2.1. Tarifat mesatare të terminimit celular sipas BEREC**


BEREC kryen publikime periodike të tarifave mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare të vendeve që bëjnë pjesë në BEREC. Në listën e vendeve që publikon BEREC aktualisht përfshihen 37 vende ku bëjnë pjesë 28 vendet anëtare të BE, vendet e zonës EEA dhe disa vende me statusin kandidat për anëtar në BE. Publikimet janë cdo gjashtë muaj dhe dokumenti i fundit i publikuar nga BEREC, *BoR (16) 218 "Termination rates at European level-*



July 2016” December 2016,<sup>2</sup> paraqet situaten e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (MTR) më 1 Korrik 2016. Dokumenti i BEREC përveç nivelit mesatar të tarifave të terminimit përmban informacion të detajuar edhe për tarifatat sipas operatorëve në çdo vend dhe metodën e aplikuar për rregullimin e tarifës së terminimit celular, përfshirë aplikimin e LRIC të pastër si dhe ‘glide path’ të parashikuar nga autoritetet rregullatore përkatëse.

Figura e mëposhtme paraqet tarifatat mesatare të terminimit MTR në secilin prej vendeve të BEREC të aplikuara më 1 Korrik 2016, si dhe tarifatat mesatare në nivel BE 28 dhe në të gjitha vendet e BEREC (37 vende). Në këtë publikim për herë të parë përfshihet dhe Shqipëria<sup>3</sup> si vend që aderon në BEREC.

FIGURA 3.1 TARIFAT MTR SIPAS VENDEVE TE BEREC (KORRIK 2016)



Burimi: BEREC, BoR (16) 218, Dhjetor 2016

Nga të dhenat vihet re se tarifatat MTR në vendet BEREC variojnë nga 0.4 eurocent në Maltë në 5.9 eurocent në Zvicër (vend që nuk bën rregullim ex-ante të MTR-ve). Tarifatat mesatare në vendet e BE dhe BEREC variojnë nga 1.04 eurocent/min, që është mesatarja e thjeshtë aritmetike


<sup>2</sup> [http://berec.europa.eu/eng/document\\_register/subject\\_matter/berec/reports/6603-termination-rates-at-european-level-july-2016](http://berec.europa.eu/eng/document_register/subject_matter/berec/reports/6603-termination-rates-at-european-level-july-2016)

<sup>3</sup> Për Shqipërinë tarifa e terminimit më 1.07.2016 është raportuar në nivelin 1.48 lek/minutë për të katër operatorët sipas vendimeve të AKEP, me shënimin se tarifa e terminimit në rrjetin Plus Communication është objekt i Vendimeve të Gjykatave të RSH.

në 28 vendet anëtare të BE (AvEU28(S)) deri në 1.27 eurocent/min që është mesatarja e thjeshtë aritmetike e 37 vendeve të BEREC (Average S). Tarifa e terminimit në Shqipëri është pak më e lartë se mesatarja e thjeshtë në vendet e BE, por më e ulët se tre mesataret e tjera të përlogarituar nga BEREC. Krahasimi i tarifave të MTR-ve në Shqipëri me tarifat mesatare të publikuara nga BEREC jepen mënyre më të detajuar në Seksionin 3.2.4.

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e tarifave mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare në vendet europiane në periudhën Janar 2004-Korrik 2016. Sipas BEREC, tarifa mesatare në vendet europiane është reduktuar me 90-92% gjatë kësaj periudhe, nga nivele 14.08/14.47 eurocent/min në Janar 2004 në 1.27/1.14 eurocent/min në Korrik 2016.

FIGURE 3.2. ECURIA E TARIFES MESARARES TE THJESHTE A(S) DHE TE PONDERUAR A(W) NË NIVEL EUROPIAN



Burimi: BEREC, BoR (16) 218, Dhjetor 2016

Tendenca e ecurisë së tarifës së terminimit në rrjetet celulare të operatorëve më të mëdhenj në Shqipëri ka qënë e ngjashme, madje edhe me ritme më të shpejta se reduktimi i mesatares së tarifave në vendet e BE/BEREC. Për dy operatorët më të hershem në treg, Telekom Albania dhe Vodafone Albania tarifa e terminimit të thirrjeve është reduktuar nga 40 lek/minute në Janar 2014 në 1.48 lek/minute në Dhjetor 2014, që përbën një reduktim me 96% gjatë kësaj periudhe,

ndërkohë që reduktimi në vlerat mesatare të publikuara nga BEREC për të njëjtën periudhë është 89-91%.

### **3.2.2. Tarifa mesatare e vendeve që kanë aplikuar LRIC të pastër**

Në vijim të vendim-marrjeve të AKEP në Mars 2014 e në vijim për rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare në Shqipëri bazuar në tarifatat benchmark të vendeve të BE/Europiane që kanë aplikuar modelin BULRIC i pastër (Pure BU-LRIC), në këtë seksion AKEP paraqet informacion të përditësuar në lidhje me aplikimin e këtij modeli dhe nga vendet anëtare të BEREC dhe vlerat përkatëse mesatare, që mund të perdoren si benchmark për rregullimin e MTR-ve në Shqipëri.

Tabela e mëposhtëme paraqet vlerat e tarifave të terminimit në 34 vendet që raporton BEREC, më 1.07.2016, si dhe informacion për vendet që kanë aplikuar LRIC deri në Korrik 2016 dhe ato që kanë marrë vendime finale për aplikim në periudhat pas Korrik 2016. Informacioni është marrë kryesisht nga raporti i BEREC i Dhjetorit 2016, por duke bërë dhe një kontroll me informacion më të përditësuar nga Cullen International<sup>4</sup>.

---

<sup>4</sup> Mobile termination rates and cost model: October 2016

TABELA 3.1: TARIFAT E TERMINIMIT CELULARE DHE APLIKIMI I LRIC I PASTËR BEREÇ 2016-2017

Nr.	Shteti	Modeli	Tarifa e terminimit (eurocent/min)	
			1.07.2016- 31.12.2016	1.01.2017- 30.06.2017
1	AT	Pure BU-LRIC	0.8049	0.8049
2	BE	Pure BU-LRIC	1.1800	1.1800
3	BG	Pure BU-LRIC	0.9715	0.9715
4	CZ	Pure BU-LRIC	0.9985	0.9985
5	DK	Pure BU-LRIC	0.7272	0.7272
6	EL	Pure BU-LRIC	1.0810	1.0810
7	ES	Pure BU-LRIC	1.0900	1.0900
8	FR	Pure BU-LRIC	0.7600	0.7400
9	HR	Pure BU-LRIC	0.8395	0.8395
10	HU	Pure BU-LRIC	0.5457	0.5457
11	IT	Pure BU-LRIC	0.9800	0.9800
12	LU	Pure BU-LRIC	0.9700	0.9700
13	MT	Pure BU-LRIC	0.4045	0.4045
14	NO	Pure BU-LRIC	0.6976	0.6976
15	PL	Pure BU-LRIC	0.9814	0.9814
16	PT	Pure BU-LRIC	0.8100	0.8100
17	RO	Pure BU-LRIC	0.9600	0.9600
18	SE	Pure BU-LRIC	0.8159	0.7426
19	SI	Pure BU-LRIC	1.1400	1.1400
20	SK	Pure BU-LRIC	1.2260	1.2260
21	UK	Pure BU-LRIC	0.6393	0.6323
22	IE*	Other/Pure BU-LRIC	2.6000/0.8200	0.8200
23	AL	Benchmark BU-LRIC	1.0699	1.0699
24	CY	Benchmark BU-LRIC	1.0112	0.9900
25	EE	Benchmark BU-LRIC	0.9200	0.9200
26	IS	Benchmark BU-LRIC	1.0032	0.8813
27	LT	Benchmark BU-LRIC	0.9400	0.9400
28	LV	Benchmark BU-LRIC	1.0500	1.0500
29	FI	other (FDC/FAC)	1.2500	1.2500
30	CH	Not regulated	5.9232	5.9232
31	NL	BU LRAIC+	1.8610	1.8610
32	DE	BU LRAIC+	1.6600	1.6600
33	MK	BU LRAIC+	1.4588	1.4588
34	TR	BU LRAIC+	0.8064	0.8064
35	LI	Benchmarking	3.5581	3.5581

<b>36</b>	<b>RS</b>	Benchmarking	2.2357	1.6829
<b>37</b>	<b>ME</b>	TD LRIC	1.1800	1.1800
<b>Mesatare</b>		<b>Eurocent</b>	<b>0.8838</b>	<b>0.8792</b>
<b>Pure BU-LRIC</b>		<b>LEK</b>	<b>1.22</b>	<b>1.22</b>

*\*Në Irlandë (IE) aplikimi i vlerës 0.82 eurocent sipas modelit Pure BULRIC ka filluar të aplikohet nga Shtatori 2016.*

Nga tabela vihet re se deri në Korrik 2016 modeli LRIC i pastër (Pure BU-LRIC) është aplikuar në 21 vende, ndërsa deri në fund të vitit 2016 është shtuar edhe Irlanda, duke e çuar në 22 numrin e vendeve që kanë aplikuar këtë model kostoje për tarifën e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare. Tarifa mesatare e këtyre 22 vendeve për vitin 2016 është 0.8838 eurocent/minutë apo 1.22 lek/minutë (kursi i këmbimit i përdorur 1 Euro=138.33 lek si edhe në raportin e BEREC). Në disa vende rregullatorët kanë vendosur për aplikim të glide path, dhe tabela pasqyron edhe vlerat që do aplikohen në gjashtëmuorin e parë 2017. Ndryshimi midis dy periudhave është i vogël dhe mesatarja në eurocent për 22 vendet me model kostoje Pure BULRIC është 0.8792 eurocent, ndërsa në lek nuk ka ndryshim dhe mesatarja rezulton përsëri 1.22 lek/minutë. Ndër vendet e tjera që pritet të aplikojnë modelin BU-LRIC të kostove është dhe Gjermania, e cila është në proces konsultimi të rezultateve të modelit.

Siç mund të vihet re edhe nga tabela, 6 vende (përfshirë Shqipërinë) rregullojnë tarifën e terminimit në rrjetet celulare duke përdorur tarifën benchmark nga vendet që kanë aplikuar modelin 'Pure-BULRIC'. Tarifën e këtyre vendeve janë përcaktuar nga rregullatorët përkatës në momente të ndryshme kohore duke përdorur informacionin e disponueshëm për aplikimin e modelit Pure BULRIC në vendet e tjera europiane/BE. Në Shqipëri, AKEP ka përcaktuar vlerën 1.48 lek/minutë në vitin 2014 duke përdorur tarifën mesatare prej 1.0550 eurocent<sup>5</sup> të 13 vendeve që kishin aplikuar modelin Pure BULRIC deri në fund të vitit 2013. Rregullimi më i fundit i bazuar në metodën 'benchmark pure BULRIC' është kryer në Islandë, e cila ka përllogaritur vlerën benchmark prej 0.8813 eurocent/min në Gusht 2016 dhe kjo vlerë do aplikohet duke filluar nga Janari 2017. Vlera benchmark e përllogaritur nga Islanda është shumë afërt me mesataren e llogaritur nga AKEP në tabelën e mësipërme në eurocent, ndërsa është e njëjtë me vlerën e shprehur në Lek me dy shifra pas presjes dhjetore (1.22 lek).

<sup>5</sup> Ndryshimi nga 1.0550 eurocent në 1.0699 eurocent për MTR e Shqipërisë vjen për shkak të ndryshimit të kursit të këmbimit euro/lek.

### 3.2.3. Asimetria/Simetria e MTR

Rekomandimi i vitit 2009 të KE për tarifën e terminimit rekomandoi përdorimin e metodës Pure BULRIC për tarifën e terminimit në rrjetet celulare dhe fikse, përfshirë aplikimin e tarifave simetrike. Seksioni i mëparshëm evidentoi se përdorimi i modelit Pure BULRIC dhe benchmarkut sipas këtij modeli është rritur ndjeshëm, dhe tashme ato përdoren në 28 vende nga 37 vende të BEREC.

Raporti i BEREC paraqet gjithashtu informacion për nivelin e MTR-ve për secilin operator rrjeti celular dhe MVNO në vendet përkatëse, ku mund të evidentohet aplikimi ose jo i asimetrisë dhe niveli i saj. Nga ky informacion rezulton se nga 37 vende të BEREC vetëm në 3 vende (Zvicër, Qipro dhe Turqi) aplikohet ende asimetri në tarifën e terminimit në rrjetet celulare. Tabela e mëposhtme paraqet informacionin e publikuar nga BEREC si dhe nivelin e asimetrisë së përlogaritur nga AKEP për këto 3 vende.

**TABELA 3.2: VENDET ME TARIFA TERMINIMI ASIMETRIKE**

Country	Operator	Average effective prices (€cent)	Subscribers	Country total subscribers	Market Share %	Niveli i Asimetrisë	
						Ne perqindje	Ne lek
CH	Swisscom	5.4283	6,561,442	10,711,066	61.26%		
	Sunrise	6.7056	2,413,228		22.53%	24%	1.77
	Salt	6.7056	1,736,396		16.21%	24%	1.77
CY	Cyta	0.99	689,406	1,135,324	60.72%		
	Primetel	1.39	60,657		5.34%	40%	0.55
	MTN	0.99	376,504		33.16%		
TR	Turkcell	0.7643	32,573,556	73,650,996	44.23%		
	Vodafone	0.7888	23,044,383		31.29%	3%	0.03
	Avea	0.9049	18,033,057		24.48%	18%	0.19

Burimi: BEREC dhe llogaritje të AKEP.

Nga tabela vihet re se niveli i asimetrisë në këto tre vende varion nga 3% në Turqi në 40% në Qipro, ndërsa niveli absolut i diferencës në tarifa varion nga 0.03 Lek në Turqi në 1.77 Lek në Zvicër.

Në Zvicër (CH) aplikohet asimetri prej 24% midis dy operatorëve më të vegjël dhe operatorit lider me 61% pjesë tregu në pajtimtarë. Megjithatë, në Zvicër tarifën MTR nuk janë objekt

rregullimi ex-ante, ato rregullohen vetëm ex-post në rast të mos-marrveshjeve midis operatorëve. Niveli i tarifave MTR të Zvicres është shumë herë më i lartë se në vendet e tjera europiane.

Në Qipro niveli i asimetrisë për operatorin më të vogël në treg është 40%. Primetel ka filluar ofrimin e shërbimeve celulare në vitin 2014 dhe sipas vendimit të rregullatorit në vitin 2015 asimetria për vitin 2016 është 40%, për vitin 2017 do jetë 20% dhe në Janar 2018 tarifat e këtij operatori do jenë simetrike me dy operatorët e tjere.

Në Turqi, aplikohet asimetri midis dy operatorëve më të vegjël dhe operatorit lider në nivel 3% dhe 18%. Kjo asimetri ka vite që aplikohet bazuar në vendimet e rregullatorit në vitin 2013. Niveli i asimetrise në vlerë absolute është shumë i ulët, 0.03 dhe 0.19 lek, për shkak se niveli i tarifave të terminimit të tre operatorëve janë afersisht ose më të ulëta se niveli mesatar në vendet që aplikojnë Pure BULRIC.

Për sa i përket asimetrisë në vende të tjera, tarifat e terminimit celular kanë arritur simetrinë në periudhën 2006-2012 në 16 vende, dhe në Janar 2013 në 9 vende të tjera. Vendimet e rregullatorëve të vendeve anëtare të BE në vitet e fundit si dhe rekomandimet e KE kanë pasur tendencë përcaktimin e tarifave simetrike edhe për MVNO v MNO, si ne Angli dhe rekomandimi i Komisionit i dates 28.11.2016 për rregullatorin Italian për tarifa simetrike midis MVNO dhe MNO.

### 3.2.4.Përmbledhje e tarifave mesatare (benchmark)

Tabela e mëposhtëme paraqet një përmbledhje të tarifave mesatare benchmark të diskutuara se seksionet e meparshme.

**TABELA 3.3: VLERAT MESATARE TË TARIFAVE TË TERMINIMIT CELULAR (BENCHMARK)**

	Eurocent	LEK	Ndryshimi me Tarifen 1.48 lek
Average EU28(S)	1.0435	1.44	-2%
Average EU28 (W)	1.0836	1.50	1%
Average BEREC 37(W)	1.2743	1.76	19%
Average BEREC 37(S)	1.1358	1.57	6%
Average BEREC 22 PURE BULRIC	0.8838	1.22	-18%

Burimi: BEREC, Përlllogaritje të AKEP

Nga tabela e mësipërme si dhe nga informacioni i seskioneve të mëparshme mund të arrihet në përfundimet se:

- Tarifa mesatare e thjeshtë e 28 vendeve anëtare të BE në 1 Korrik 2016 ishte 1.44 lek/minutë, ndërsa tarifa mesatare e ponderuar ishte 1.50 lek/minutë. Këto vlera janë shumë të përafërta me nivelin aktual të MTR në Shqipëri prej 1.48 lek/minute, me ndryshim +1% dhe -2%;
- Tarifa mesatare e thjeshtë e 37 vendeve të BEREC (që përfshin edhe vende të rajonit dhe Shqipërinë) më 1 Korrik 2016 ishte 1.57 lek/minutë, ndërsa mesatarja e ponderuar 1.76 lek/minutë. Këto vlera janë 6% dhe 19% më të larta se niveli aktual prej 1.48 lek/minutë në Shqipëri;
- Niveli mesatar i tarifave të terminimit në vendet e BEREC në Korrik 2016 është reduktuar me 43% (mesatarja e thjeshtë) dhe 22% (mesatarja e ponderuar) në krahasim me Korrik 2013;
- Deri në vitin 2013 nga 34 vende të BEREC, 13 vende kishin aplikuar tarifën e terminimit celular bazuar në modelin e kostove BU-LRIC të pastër, dhe vlera mesatare ishte 1.055 eurocent/minutë apo 1.48 Lek/minute;
- Deri në vitin 2016 nga 37 vende të BEREC, 22 vende kanë aplikuar modelin BU-LRIC të pastër, dhe 6 vende kanë aplikuar benchmark mbi tarifën e aplikuar në vendet me këtë model kostoje.
- Tarifa mesatare e terminimit e 22 vendeve që kanë aplikuar modelin BU LRIC të pastër deri në fund të vitit 2016 është 0.8838 eurocent/minutë, apo 1.22 lek/minute.
- Tarifat e terminimit në rrjetet celulare janë simetrike në pothuajse të gjitha vendet e BEREC që prej vitit 2013, me përjashtim të 3 vendeve, por edhe këto me specifika të veta dhe me nivele shumë të ulëta të asimetrisë në terma absolute.



# 4. Rregullimi i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare në Shqipëri

---

## 4.1 Alternativat për rishikimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare

Siç është evidentuar në seksionin e Hyrjes, AKEP (më parë ERT) përgjate viteve 2006-2016 ka përdorur një sërë mënyrash të rregullimit të tarifave në rrjetet celulare:

- nëpërmjet procedurave të zgjidhjes se mos-marrvshjeve duke përcaktuar çmime maksimale për tarifat e terminimit celular;
- nëpërmjet statusit së FNT dhe rregullimit të nivelit maksimal të tarifave të terminimit celular, bazuar:
  - o Në nivelet mesatare të tarifave të terminimit në vendet e BE dhe/ose normës së ndryshimit të tyre;
  - o Në rezultatet e modelit të kostove BULRAIC + të përgatitur në vitin 2010
  - o Në nivelin mesatar të tarifave të terminimit në vendet europiane që kanë aplikuar modelin e kostove Pure BURIC: viti 2014 e në vijim
  - o Në përdorimin e reduktimit të përshkallëzuar (glide path) për të arritur në nivelin e synuar (benchmark ose kosto BULRAIC).

Rekomandimi i KE i datës 7 Maj 2014, në pikën 12 të tij trajton rastin e vendeve me kapacitete dhe kohë të kufizuar për ndërtimin e modelit LRIC të pastër, duke rekomanduar që këto vende të aplikojnë metoda alternative (si benchmark), por rezultatet e tyre nuk duhet të jenë më të mëdha se tarifa mesatare e terminimit e vendosur nga Autoritetet Rregullatore që kanë aplikuar metodologjinë e LRIC të pastër. AKEP në vitin 2014, në dokumentin dhe vendimet e Mars 2014 përllorarit nivelin e tarifës mesatare në vendet që kishin aplikuar BULRIC të pastër dhe kreu rregullime me glide path të tarifave të terminimit për të arritur nivelin benchmark të llogaritur. Gjatë kësaj periudhe numri i vendeve që kanë aplikuar modelin e kostove BULRIC i pastër është

rritur nga 13 në vitin 2013 në 22 në vitin 2016, si dhe 5 vende të tjera, si edhe Shqipëria rregullojnë tarifën e terminimit celulare bazuar në tarifën benchmark të vendeve që aplikojnë modelin BULRC të pastër.

AKEP nëpërmjet vendimeve të Analizës së tregut në Nëntor 2014 rishikoi grafikun e reduktimit të përshkallëzuar (glide path) të përcaktuar në Mars 2014, duke përshpejtuar arritjen e nivelit benchmark prej 1.48 lek/minute. Ky përshpejtim u krye në kushtet e vendosjes së masave të tjera rregulluese për FNT, dhe sidomos për të adresuar problematikën e diskriminimit në tarifën e thirrjeve on-net/off-net. Detyrimet e vendosura për FNT në 2014 dhe rishikimi i tyre në Mars 2015 janë përshkruar në dokumentin e analizës së tregut 2016, përfshirë efektin pozitiv në tregun me pakicë në lidhje me trafikun dhe tarifën e thirrjeve on-net/off-net. AKEP vlerëson se këto efekte pozitive kanë ardhur si pasojë e zbatimit të detyrimit të mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net të shoqëruar me reduktim të ndjeshme të tarifave të terminimit të katër operatorëve celularë.

### **Metoda e rregullimit**

Sipas nenit 57 të ligjit 9918, **Metoda e rregullimit të tarifave:**

1. AKEP-i zbaton rregullimin e tarifave nëpërmjet metodave të mëposhtme:

a) përcaktimit të nivelit minimal ose maksimal të tarifave;

b) korigjimit të ecurisë së tarifave, duke përcaktuar kushte të tilla si:

i) kufirin maksimal të normës së ndryshimit (rritjes/uljes) të mundshëm të tarifës brenda një periudhe të caktuar kohe;

ii) raportin maksimal të rritjes së tarifës, që imponohet nga rritja e çmimeve të elementeve përbërëse (inputeve), brenda një periudhe kohe të caktuar;

iii) procedura, që do të përdoret për përcaktimin ose llogaritjen e tarifës, përfshirë detyrimin për orientimin në kosto, përcaktimin e kostove efiçente, që mundëson realizimin e një fitimi të arsyeshëm;

c) përcaktimin e një periudhe kohore, në asnjë rast më të gjatë se 12 muaj, gjatë së cilës ndalohet rritja e tarifave mbi nivelin aktual të tyre në një treg përkatës.

2. Në rregullimin e tarifës, bazuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i vlerëson edhe të dhënat më të fundit për:

a) praktikën më të mirë të vendeve të BE-së;

b) tarifën mesatare të vendeve të BE-së;

c) tarifën e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë;

ç) raportet ndërmjet tarifave të shumicës dhe pakicës;

d) normën e fitimit të arsyeshëm, të realizuar nga sipërmarrësit e tjerë të komunikimeve elektronike në vendet e BE-së dhe në vendet me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë.

3. Metodatat e rregullimit të tarifave mund të jenë të kombinuara.

4. Sipërmarrësit, që kanë detyrimin për të zbatuar detyrimet e veçanta dhe rregullimin e tarifave, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 56, duhet të aplikojnë paraprakisht në AKEP për miratimin e tarifave, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vendimin e AKEP-it për rregullimin e tarifave.

5. AKEP-i ose një ekspertizë kontabël e pavarur e përzgjedhur nga ajo, verifikon përputhshmërinë e tarifave nën rregullim me metodën dhe kushtet e përcaktuara për rregullimin e tarifave.

AKEP vlerëson se mënyra më efikase dhe më e mirë për rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare do të ishte metoda e përcaktimit të nivelit maksimal të tyre. Në lidhje me informacionin që duhet të përdoret për përcaktimin e nivelit maksimal të tarifave të terminimit celular, AKEP gjykon si alternativë më të mirë përdorimin e tarifave benchmark dhe praktikave më të mira në vendet e BE dhe rajonit (BEREC). Rregullimi i tarifave sipas nivelit benchmark (mesatar) është një praktikë e ndjekur nga AKEP më parë si dhe një praktikë e lejuar nga Ligji 9918, Neni 7, pika 1 dhe neni 57, pikat 1/a dhe 2.

Në lidhje me këtë zgjedhje, AKEP vlerëson se dy alternativat kryesore janë:

1. Niveli mesatar i tarifave në vendet e BE (AVG EU 28: 1.44 dhe 1.50 lek/minutë);
2. Niveli mesatar i tarifave në vendet e BEREC që kanë aplikuar modelin e kostove Pure BULRIC (AVG BEREC 22 Pure BULRIC: 1.22 lek/minutë).

Bazuar në përfundimet e analizës së tregut 2016 si dhe në efektet e dhëna në tregun me pakicë rregullimi i tarifës së terminimit në vitin 2014, sipas alternativës 2 më sipër, dhe vijimi i zbatimit të detyrimit të mosdiskriminimit në tarifatat e thirrjeve on-net/off-net nga operatorët celulare edhe në 2-3 vitet në vijim (propozimi në analizën e tregut celulare 2016), **AKEP propozon që rregullimi i tarifave të terminimit të vijojë të rregullohet sipas alternative 2, duke përdorur informacionin e përditësuar për vendet që kanë aplikuar modelin e kostove Pure BULRIC deri në vitin 2016, pra duke reduktuar tarifatat e terminimit nga 1.48 lek/minutë në 1.22 lek/minutë.**

## 4.2 Asimetria/Simetria dhe afati i aplikimit

Niveli i tarifës së terminimit prej 1.22 lek/ minutë i propozuar nga AKEP për rregullimin e tarifave të terminimit përbën një nivel të synuar (target) për tarifën e terminimit të operatorëve celularë. Në lidhje me këtë nivel shtrohen dy pyetje:

- A duhet të aplikohen tarifa simetrike apo asimetrike midis operatorëve celularë?
- Kur duhet të fillojë aplikimi i kësaj tarife dhe a është e nevojshme të aplikohet një glide path për të arritur në këtë nivel?

### 4.2.1. Tarifa terminimi Asimetrike v Simetrike

Një çështje e diskutuar në analizat dhe dokumentat e mëparshme të AKEP ka qënë aplikimi i tarifave asimetrike të terminimit midis operatorëve më të mëdhenj dhe të hershëm në treg në raport me operatorët më të vegjël dhe hyrës më të vonë në treg. Ecuria e tarifave të terminimit të dhënë në grafikët e kapitullit II evidenton asimetrinë e aplikuar ndër vite për Albtelcom(EM) dhe për Plus në raport me Vodafone dhe Telekom Albania. Tabela e mëposhtme paraqet asimetrinë në përqindje dhe në vlerë absolute të tarifave të terminimit të Albtelcom dhe Plus Communication në raport me tarifën e terminimit të Vodafone dhe Telekom Albania.

TABELA 4.1: ASIMETRIA E TARIFAVE TË TERMINIMIT TË ALBTELECOM DHE PLUS

	Albtelcom (EM)		Plus	
	%	Lek/minute	%	Lek/minute
<b>Mars 2008</b>	11%	1.75		
<b>Shtator 2008</b>	11%	1.37		
<b>Shtator 2009</b>	23%	2.42		
<b>Nentor 2010</b>	23%	2.42	80%	8.40
<b>Mars 2011</b>	23%	2.04	114%	10.05
<b>Shtator 2011</b>	17%	1.28	150%	11.33
<b>Shtator 2012</b>	7%	0.42	112%	6.82
<b>Shtator 2013</b>	0%	0.00	94%	4.28
<b>Prill 2014</b>	51%	1.34	145%	3.86
<b>Dhjetor 2014</b>	0%	0.00	341%	5.04
<b>Prill 2015</b>	0%	0.00	170%	2.52
<b>Korrik 2015</b>	0%	0.00	80%	1.18
<b>Prill 2016</b>	0%	0.00	0%	0.00
<b>Kohëzgjatja totale e asimetrisë (sipas Vendimeve të AKEP)</b>		74 muaj		64 Muaj

Kohëzgjatja totale e asimetrisë së Albtelecom (EM) ka qënë 74 muaj dhe niveli i asimetrisë së EM ka qënë 7-23% për rreth 5 vjet dhe 51% në për muaj në periudhën Prill-Nëntor 2014. Niveli i asimetrisë absolute të Plus ka qënë 0.42 -2.42 lek minutë.

Kohëzgjatja totale e asimetrisë së Plus sipas vendimeve të AKEP ka qënë 64 muaj dhe niveli minimal i asimetrisë së Plus ka qënë 80% duke arritur dhe në 341% në periudhën Dhjetor 2014-Prill 2015. Siç është theksuar në dokumentin e analizës së tregut dhe në këtë dokument Vendimet e AKEP në periudhën Mars 2015-Prill 2016 që kanë pasur lidhje me përcaktimin e tarifës së terminimit në rrjetin Plus dhe arritjen e simetrisë së tarifës së këtij operatori me tre operatorët e tjerë janë objekt shqyrtimi gjyqësor.

AKEP në vlerësimin për aplikimin ose jo të asimetrisë si dhe kohëzgjatjen dhe nivelin e saj ka marrë në konsideratë rekomandimet e KE dhe BEREC, dhe përvojën më të mirë në vendet e tjera për aplikimin e asimetrisë, dhe sidomos rekomandimet e dokumentit të ERG (sot BEREC): (*ERG's Common Position on symmetry of fixed call termination rate and symmetry of mobile call termination rates, ERG (07) 83 final 080312*). Disa nga përfundimet dhe rekomandimet kryesore të këtij dokumenti në lidhje me asimetrinë e MTR janë:

- Tarifat e terminimit normalisht duhet të jenë simetrike dhe asimetria, e pranueshme në disa raste, duhet të jetë e justifikuar. Asimetria e tarifave të terminimit është një element rregullator që justifikohet për t'u aplikuar në **periudhë tranzitore dhe të përcaktuar në kohë** për hyrësit e rinj në treg në dy raste kryesore:
  - o Ndryshimet në kosto për në rastet kur midis operatorëve ka diferenca në frekuencat e dhëna në përdorim për shërbimet tradicionale si p.sh një operator që ka akses vetëm në brezin 1800MHz dhe nuk ka në përdorim frekuenca në brezin 900 MHz (me kosto më të ulët për mbulim me rrjet).
- Plus nuk ndodhet në këto kushte, pasi ai ka marrë frekuenca në përdorim në të dy brezat 900 MHz dhe 1800 MHz dhe sasia në dispozicion në brezin 900 MHz me kosto më të ulët për mbulimin me sinjal celular është e barabartë për të katër operatorëve.
- o Hyrja me shumë vonesë në treg në raport me operatorët e tjerë të konsoliduar tashme në treg.

Ky element është përdorur për Plus nga AKEP ndër vite dhe tabela e mësipërme evidenton nivelin dhe kohëzgjatjen e asimetrisë të përcaktura në vendimet e AKEP për tarifën e terminimit për Plus.

- Në çdo rast, **asimetria duhet të jete e përkohshme dhe e përcaktuar në kohe** (periudhë tranzitore dhe e përcaktuar me grafik kohor se kur do arrihet simetria), si dhe **në nivele të arsyeshme**.

Dokumenti i cituar i BEREC (ERG 07 83 final 080312) në faqen 94, rekomandon që kohëzgjatja e asimetrisë për një operator celular hyrës të ri është deri në 5 vjet dhe sipas niveleve të mëposhtëme:

Viti	1	2	3	4	5	6
Asimetria në%	50%	40%	30%	20%	10%	0%

Pavaresisht niveleve të rekomanduara te ERG, AKEP duke marrë në konsideratë kohën e hyrjes në treg të Plus dhe faktore të tjere specifike të tregut në Shqipëri, ka lejuar për nivele shumë të larta të asimetrisë për Plus 80% deri në 340%.

AKEP në të gjitha vendimet për tarifën e terminimit celular, përfshirë orientimin në kostot BULRAIC) ka përcaktuar gjithmonë një grafik kohor (glide path) për arritjen e simetrisë midis katër operatoreve celulare. AKEP vetem në vendimet e Nëntor 2014, nuk përfshiu një glide path për arritjen e simetrisë, dhe kjo u rregullua me vendimet e Mars 2015.

- Zgjidhja më e mirë për adresimin e problemeve të diskriminimit në tarifën on-net/off-net të dhe disbalancës së trafikut dalës dhe hyrës për operatorët e vegjël (më shumë trafik dalës se hyrës) është orientimi në kosto të MTR-ve të operatorëve (sidomos operatorëve të mëdhenj). Edhe në lidhje me këtë rekomandim, AKEP ka marrë masa për orientimin në kosto të MTR, sidomos të operatorëve më të mëdhenj. Kapitulli II, përmban një përmbledhje të rregullimeve të kryera nga AKEP.

Dokumenti i BEREC (ERG 07 83 final 080312) në përfundim të kapitullit për asimetrinë e MTR, në faqen 101, ka përmbledhur kushtet kryesore që justifikojnë/nuk justifikojnë asimetrinë në MTR për një periudhë tranzitore, në seksionin, ***Justifikimi i asimetrisë për një periudhë tranzitore përpara se MTR të jenë në kosto***, ku ndër të tjera citon:

Në varësi të specifikave kombëtare si pjesët e tregut, struktura e tarifave me pakicë, faktoret që klientët marrin në konsideratë për zgjedhjen e operatorit, **rregullatori mund të aplikojë për një periudhë tranzitore tarifa asimetrike** në favor të operatorit (operatorëve) më të vëgjel në rrethanat e mëposhtme kumulative:

- Për shkak të strategjive të operatorëve (diferenca të mëdha në tarifat on-net dhe off-net) midis operatorëve ka disbalanca të mëdha trafiku dhe pagesash interkoneksioni;
- MTR janë shumë më të larta se kostot;
- Kur rregullatori vleron se aplikimi për një periudhë tranzitore i tarifave asimetrike sjell përfitime për tregun (si rritje e mundshme e konkurrencës në nivel me pakicë) dhe këto janë më të mëdha se disavantazhet në periudhë afatshkurtër.

Rrjedhimisht, **asimetria nuk është më e justifikuar** kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:<sup>6</sup>

1. nuk ka më disbalanca të trafikut ose ato nuk vijnë për shkak të strategjive të operatoreve;
2. MTR-të e operatorëve të mëdhenj nuk janë shumë më të larta se kosto.

AKEP në dokumenta dhe vendime të mëparshme për eliminimin e asimetrisë së Plus ka argumentuar ndër të tjera se asimetria për tarifën e terminimit të Plus nuk është më e justifikuar me reduktimin e ndeshëm të tarifave të terminimit të tre operatoreve të tjerë celularë në nivelin 1.48 lek/minutë duke filluar nga Dhjetor 2014, si dhe me eliminimin e diferencave në tarifat on-net dhe off-net duke filluar nga Korrik 2015 dhe Janar 2016.

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e trafikut neto midis operatorëve celularë (trafikun hyrës nga operatorët e tjerë celularë minus trafikun off-net drejt operatorëve të tjerë celularë) në bazë mujore në periudhën Janar 2014-Shtator 2016.


---

<sup>6</sup> ERG 07 83 final 080312, faqe 101:

Therefore, this asymmetry will not be justifiable anymore if one of the following conditions is observed:

- The situation with traffic imbalances disappears or they do not result of operators' strategies
- MTR of the large operator(s) is not set significantly above costs

FIGURA 4.1: ECURIA E TRAFIKUT NETO MIDIS OPERATORËVE CELULARE 2014-16



Burimi: AKEP, bazuar në të dhënat mujore të dërguara nga operatorët

Të dhënat tregojnë se trafiku neto i operatorëve është ndikuar ndjeshëm nga fillimi i zbatimit të detyrimit të mos-diskriminimit në tarifatat e thirrjeve on-net dhe off-net në Korrik 2015. Ky detyrim u zbatua në dy faza:

- Nga 1 Korrik 2015: për të gjithë përdoruesit me parapagim dhe përdoruesit me kontratë që kryen rinovim kontrate pas kësaj date;
- Nga 1 Janar 2016: të gjithë përdoruesit e tjerë me kontratë (përfshirë ata me kontrata specifike).

Nga figura mund të vihet re se Plus duke filluar nga Shtator 2015 ka pasur trafik neto pozitiv, d.m.th më shumë trafik hyrës së dalës drejt operatorëve të tjerë celularë. Madje edhe në periudhat e mëparshme, megjithëse Plus ka pasur trafik neto negative, niveli i asimetrisë së tarifës së terminimit në rrjetin Plus ka bërë që, efekti neto në të ardhurat e Plus nga terminimi (të ardhura hyrëse nga terminimi në rrjetin e vet-shpenzime për terminim në operatorët e tjerë) të jetë shumë pozitiv, pra duke i rritur aftësinë konkurruese.

Balancat e trafikut të tre operatorëve të tjerë celularë kanë pasur ndryshime, ku vihet re se:

- Telekom Albania nga trafik neto pozitiv ka kaluar në trafik neto negativ që prej muajit Tetor 2015 e në vijim;



- Vodafone Albania ka trafik neto pozitiv gjatë gjithë periudhës, por me rënie të ndjeshme në Korrik 2015 e në vijim, më pas rritje në Korrik 2016 e në vijim;
- Albtelecom (EM) ka pasur vazhdimisht trafik neto negative, por me rritje të ndjeshme në Maj-Korrik 2015, më pas me ulje të ndjeshme nga Gusht 2015, por përsëri rritje në Gusht dhe Shtator 2016.

Për sa më sipër, kushti i parë i ERG që nuk justifikon vazhdimin e asimetrisë në MTR është zbatuar, pasi disbalancat e trafikut për Plus nuk ekzistojnë me dhe disbalancat që mund të vihen re tashme nuk vijnë nga strategjitë e operatorëve për diferenca në tarifa on-net/off-net, pasi përfundimisht që prej Korrik 2015 dhe Janar 2016 këto tarifa janë të njëjta dhe pa diskriminim.

Kushti i dytë që nuk justifikon asimetrinë gjithashtu është realizuar pasi që prej datës 1.12.2014 tarifat e terminimit të Vodafone, TA dhe Albtelecom janë të orientuara drejt mesatares së kostove BULRAIC i pastër në vendet europiane, që është standardi i kostove, i rekomanduar së fundmi nga KE.<sup>7</sup>

Për sa më sipër, qëndrimi dhe vleresimi i AKEP, bazuar në praktikat më të mira europiane dhe rekomandimet e BEREC (ERG), për asimetrinë e tarifave të terminimit celular, është i njëjtë si në dokumenta dhe vlerësimet e mëparshme të AKEP:

- Asimetria duhet të aplikohet për një periudhë të caktuar/kufizuar kohore dhe përcaktuar qartë se kur arrihet simetria (glide path deri në simetri);
- Hyrja me vonesë e Plus si faktori më i rëndësishëm për përcaktimin e nivelit të asimetrisë është marrë në konsideratë nga AKEP në vendimet për tarifat e terminimit celular
- Plus nuk është operator që përdor vetëm breza në 1800 Mhz apo më sipër, pasi si ka në përdorim frekuenca në brezin 900 MHz dhe në sasi të barbartë me tre operatorët e tjerë
- Me orientimin e MTR-ve të tre operatorëve të tjerë celularë në benchmarkun e kostove PURE BULRIC të vendeve të BEREC duke filluar nga 1.12.2014, e shoqëruar edhe me zbatimin e detyrimit të mos-diskriminimit në tarifat me pakicë on-net/off-net, nuk ka më asnjë rrethanë/kusht që të justifikojë asimetrinë në MTR.

---

<sup>7</sup> Tarifat e terminimit të Vodafone dhe Telekom Albania janë përcaktuar sipas nivelit mesatar të tarifave të terminimit në vendet e BE që në vitin 2006, dhe më pas kanë qenë afërsisht sa ky nivel deri në vitin 2012. Në Shtator 2013 tarifat e terminimit të Vodafone, TA dhe Albtelecom u barazuan me koston BULRAIC+, modeli i rekomanduar nga KE për shume vite, përfshirë vitin 2007 kur është publikuar dokumneti i cituar i ERG.

#### 4.2.2. Afati i fillimit të aplikimit të tarifës së re MTR

AKEP vlerëson se afati i përshtatshëm për fillimin e aplikimit të tarifës së re të terminimit celular në nivelin 1.22 lek/minute për të katër operatorët është data 1 Shtator 2017, pa aplikim të reduktimit të përshkallëzuar. Kjo periudhe vlerohet si e përshtatshme nder të tjera për shkaqet e mëposhtëme:

- koha e nevojshme për proceset e konsultimit publik

Vendimi final për miratimin e tarifës së terminimit të re do të merret nga AKEP pas miratimit të versionit final të dokumnetit të analizes së tregut që është në proces këshillimi publik deri më 7.02.2017 dhe miratimit të versionit final të këtij dokumenti që do jetë në këshillim publik deri më 7.02.2017. Përgatitja e versioneve finale të këtyre dokumentave si dhe proceset e mundshme të ankimeve administrative kërkojnë kohën e duhur për një vendim-marrje të arsyetuar.

- Kohe e nevojshme për operatorët

Megjithëse reduktimi është vetëm 18%, operatorët duhet të përshtasin planet e tyre si dhe një afat gjashtëmujor për zbatim nga marrja e vendimit final të AKEP vlerësohet e arsyeshme. Njëkohësisht vlen të theksohet se niveli aktual 1.48 lek/minute i MTR në Shqipëri është pothuajse sa mesatarja e thjeshtë e MTR në vendet e BE 28 dhe më i ulët se mesatarja e ponderuar në BE 29 dhe tarifa mestare (e thejshme dhe e ponderuar) e BEREC.

Për sa më sipër, propozimi i AKEP për rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare është si në tabelën më poshtë:

TABELA 4.2: VLERAT MAKSIMALE TË TARIFAVE TË TERMINIMIT CELULAR NË SHQIPËRI 2017-

	Aktuale	1.09.2017 - deri ne nje vendim tjeter te AKEP <sup>8</sup>
<b>Vodafone/TA/Albtelecom</b>	1.48	1.22
<b>Plus</b>	1.48 - 6.52 <sup>9</sup>	1.22

*Shënim: Tarifat në lek/minute pa TVSH*

<sup>8</sup> Sipas procedurës së përcaktuar për rregullimin e tarifave të sipërmarrësve me FNT në nenin 55 e në vijim të ligjit 9918.

<sup>9</sup> Objekt i vendimeve të gjykatave.

Tarifa e terminimit të thirrjeve në rrjetin e Plus Communication në periudhën 1.04.2015 e në vijim (deri në datën e përcaktuar në vendimin final sipas këtij dokumenti) është objekt i disa proceseve gjyqësore dhe vendimeve të gjykatave (shiko Kapitullin 2), për të cilat AKEP nuk mund të bëjë interpretim të tyre.

### **4.3. Efektet e Pritshme**

AKEP në dokumentin e analizës së tregut të nxjerrë në këshillim publik ka evidentuar efektet positive në treg të aplikimit të detyrimit të mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net si dhe të reduktimit të nivelit të tarifave MTR, të cilat për tre operatorët kryesore arritën nivelin 1.48 lek/minutë, sa niveli i tarifës mesatare në vendet e BEREC që kishin aplikuar modelin BULRIC i pastër deri në vitin 2013.

Në këtë dokument AKEP propozon për një reduktim të mëtejshëm të MTR nga niveli aktual 1.48 lek/minutë në 1.22 lek/minutë, që është sa niveli i tarifës mesatare në vendet e BEREC që kishin aplikuar modelin BULRIC i pastër deri në vitin 2016. Ky nivel i ri përbën një reduktim prej 18% nga niveli aktual, dhe është më i ulët se niveli mesatar (i thjeshtë apo i ponderuar) i MTR-ve aktuale (Korrik 2016) në vendet BE 28 dhe BEREC (37 vende europiane).

Në vijim të reduktimeve të kryera më parë nga AKEP për MTR si dhe të zbatimit të detyrimeve të mos-diskriminimit në tarifën on-net/off-net, reduktimi i propozuara i MTR në këtë dokument gjykohet se do të japë një impuls shtesë pozitiv në rritjen e mëtejshme të konkurrencës në tregun celular me pakicë në Shqipëri dhe përfitimeve të përdoruesve të shërbimeve celulare. Orientimi në koston LRIC të pastër gjykohet si një nga masat me efekt më të madh në rritjen e konkurrencës në treg dhe aftësisë konkurruese të operatorëve më të vegjël nëpërmjet reduktimit të shpenzimeve të tyre për thirrjet off-net.

# Aneks 1: Pyetjet e keshillimit publik

---

Më poshtë është një përmbledhje e pyetjeve për të cilat AKEP është i interesuar të marrë komente nga palët e interesuara. Në përgjigjet e dhëna për pyetjet, palët janë të lutura të përfshijnë edhe argumentim për përgjigjet/komentet. Palët mund të japin komente edhe për pjesë të tjera të dokumentit të nxjerrë në këshillim dhe propozimeve të AKEP, apo dhe sugjerime shtesë për një rregullim sa më të mirë të tarifave me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare.

1. A janë pasqyruar drejt tarifavat benchmark të vendeve të BE dhe BEREC për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare në **Seksionin 3**?
2. A jeni dakort me propozimin e AKEP për aplikimin e metodës së përcaktimit të çmimit maksimal duke përdorur informacionin për tarifavat në vendet e tjera (BE dhe BEREC), pra me tarifa benchmark?
3. A jeni dakort që AKEP duhet të vazhdojë të përdorë si benchmark tarifën mesatare të terminimit në vendet e BEREC që kanë aplikuar modelin BULRIC i pastër?
4. A jeni dakort me përfundimin e AKEP se tarifa e terminimit duhet të aplikohet e njëjtë për të katër operatorët celulare, pra në MTR simetrike?
5. A jeni dakort me nivelin e propozuar të MTR 1.22 lek/minutë dhe cili është afati më i arsyeshëm për fillimin e aplikimit të tarifës së re?

## Aneks 2: Lista e Shkurtimeve të Shteteve

---

<b>Simboli</b>	<b>Shteti</b>
<b>AL</b>	Shqipëri
<b>AT</b>	Austri
<b>BE</b>	Belgjik
<b>BG</b>	Bullgari
<b>CH</b>	Zvicër
<b>CY</b>	Qipro
<b>CZ</b>	Çeki
<b>DK</b>	Danimarkë
<b>DE</b>	Gjermani
<b>EE</b>	Estoni
<b>EL</b>	Greqi
<b>ES</b>	Spanje
<b>FI</b>	Finlandë
<b>FR</b>	Francë
<b>HR</b>	Kroaci
<b>HU</b>	Hungari
<b>IE</b>	Irlandë
<b>IS</b>	Islandë
<b>IT</b>	Itali
<b>LI</b>	Liechtenstein
<b>LT</b>	Lituani
<b>LV</b>	Letoni
<b>LU</b>	Luksemburg
<b>ME</b>	Mali i Zi
<b>MT</b>	Malta
<b>FYROM</b>	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
<b>NL</b>	Hollandë
<b>NO</b>	Norvegji
<b>PL</b>	Poloni
<b>PT</b>	Portugali
<b>RO</b>	Rumani
<b>RS</b>	Serbi
<b>SE</b>	Suedi
<b>SI</b>	Sllloveni
<b>SK</b>	Slllovaki
<b>TR</b>	Turqi
<b>UK</b>	Mbreteria e Bashkua(Angli)